



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KRYETARI

Nr. 1539 prot.

Korçë më, 26/02/2019

**URDHËR**

Nr. 127, datë 26/02/2019

**Për një shtesë në urdhërin nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar**

Pasi shqyrtova relacionin e datës 25.02.2019, paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit, lidhur me oraret e funksionimit dhe stacionet e qëndrimit të linjës të rregullt rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve, Mborje–Korçë–Mborje dhe oraret e linjës rrethqytetëse Vithkuq–Korçë–Vithkuq, mbështetur në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 64, pika b; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, neni 3; vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 17, datë 03.03.2017, pika 2, "Për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar;

**URDHËROJ:**

1. Në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, për Njësinë Administrative Drenovë, kryhet shtesa për linjën Mborje–Korçë–Mborje, oraret e nisjes e kthimit dhe stacionet e qëndrimit do të jenë si më poshtë:

1.	LINJA NR. 2/2	Mborje – Korçë – Mborje
2.	Oraret e nisjes	07 <sup>00</sup> , 07 <sup>30</sup> , 08 <sup>00</sup> , 08 <sup>30</sup> , 09 <sup>00</sup> , 09 <sup>30</sup> , 10 <sup>00</sup> , 10 <sup>30</sup> , 11 <sup>00</sup> , 11 <sup>30</sup> , 12 <sup>00</sup> , 12 <sup>30</sup> , 13 <sup>00</sup> , 13 <sup>30</sup> , 14 <sup>00</sup> , 14 <sup>30</sup> , 15 <sup>00</sup> , 15 <sup>30</sup> , 16 <sup>00</sup> .
3.	Oraret e kthimit	07 <sup>30</sup> , 08 <sup>00</sup> , 08 <sup>30</sup> , 09 <sup>00</sup> , 09 <sup>30</sup> , 10 <sup>00</sup> , 10 <sup>30</sup> , 11 <sup>00</sup> , 11 <sup>30</sup> , 12 <sup>00</sup> , 12 <sup>30</sup> , 13 <sup>00</sup> , 13 <sup>30</sup> , 14 <sup>00</sup> , 14 <sup>30</sup> , 15 <sup>00</sup> , 15 <sup>30</sup> , 16 <sup>00</sup> , 16 <sup>30</sup> .
4.	Stacionet	Mborje & Korçë.

2. Në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, oraret e linjës rrethqytetëse Vithkuq-Korçë-Vithkuq, ndryshohen si më poshtë:


1.	LINJA NR. 5/1	Vithkuq – Korçë – Vithkuq
2.	Oraret e nisjes	07 <sup>00</sup> , 07 <sup>30</sup> , 13 <sup>00</sup> .
3.	Oraret e kthimit	07 <sup>40</sup> , 12 <sup>30</sup> , 14 <sup>10</sup> .

3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Policia Bashkiake Korçë .
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi  
N. Lika



Drejtorja Juridike  
A. Dishnica



**KRYETARI**

